

platforma

CiviKos

Raport vjetor 2014

Kuvendi i anëtarëve të Platformës CiviKos

Më 4 Prill 2014 në Restaurant Sheshi 21 Platforma CiviKos mbajti kuvendin vjetor të anëtarëve. Në kuvend morën pjesë më shumë se 75 përfaqësues të organizatave anëtare dhe jo anëtare, ku 68 pjesëmarrës nga organizatat anëtare ishin me të drejtë vote. Në këtë kuvend u zgjodh bordi i ri i Platformës CiviKos i përbërë nga: Taulant Hoxha (KCSF), Sihana Mehmeti (KFOS), Driton Selmanaj (KDI), Feride Rushiti (QKRMT), Petrit Tahiri (KEC), Bujar Kadriu (Shoqata e të verbërve të Kosovës), Hajrulla Çeku (EC Ma Ndryshe), Petrit Zogaj (Lëvizja FOL) dhe Hilmi Jashari (CRP Kosovo), të cilët në mënyrë demokratike dhe transparente u votuan nga anëtarët prezent në kuvend. Në këtë kuvend u miratuan dhe hynë në fuqi dokumentet si: Kodi Etik, Rregullorja e Punës për aktivitetet e Civikos, Rregullorja e Bordit, si dhe u ndryshuan dy nene në Statutin e Platformës Civikos: neni 1.2 dhe 8.2. Përveç dokumenteve të lartpërmendura u prezantua dhe u miratua raporti i punës dhe ai financiar për periudhën 2012-2013.



Planifikimi Strategjik i Platformës CiviKos

Sekretariati i Platformës CiviKos së bashku me anëtarët e bordit të CiviKos, dhe me mbështetje të TACSO zyra në Kosovë nga data 04.07.2014 - 06.07.2014 në Hotel Magra Austria në Bogë- Rugovë mbajtën punëtorinë e përbashkët ku hartuan planin strategjik të Platformës CiviKos për periudhën 2015-2017. Punëtorja përfshiu përcaktimin e vizionit dhe misionit të CiviKos-it, SWOT Matricën, prioritizimi i mundësive dhe rreziqeve, prioritizimi i anëve të forta dhe të dobëta, prioritizimi i objektivave strategjike të CiviKos, metodologjia e punës së CiviKos si dhe planin e veprimit për finalizimin e strategjisë.

Tri objektivat Strategjike të Platformës CiviKos të dala nga punëtorja janë:

- Objektivi strategjik 1 - Fuqizimi i marrëdhënieve me anëtarët dhe jo-anëtarët dhe portfolio e zgjeruar e shërbimeve,
- Objektivi strategjik 2 - Koordinim i shoqërisë civile për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile,
- Objektivi strategjik 3 - Zhvillimi i dialogut të strukturuar mes shoqërisë civile dhe autoriteteve tjera publike



Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017

Themelimi i Këshillit për mbikëqyrje të implementimit të strategjisë

Në mënyrë që të sigurohet implementimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 është paraparë të themelohet edhe Këshilli për Mbikëqyrje të Implementimit të Strategjisë Qeveritare 2013-2017. Vendimi për themelimin e këtij këshilli është marrë në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës me datë 02.04.2014 ku u vendosë që ky këshill të përbëhet nga 29 anëtarë, 14 prej të cilëve janë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe 15 anëtarë nga shoqëria civile. Me kërkesë të organizatave të shoqërisë civile është vendosur që niveli i përfaqësimit të anëtarëve të këshillit nga ana e qeverisë të mos jetë në nivel politikë, ndërsa përfaqësuesit e shoqërisë civile të përzgjidhen me anë të procesit të votimit, që është organizuar nga sekretariati i Platformës CiviKos.

Me 25 Prill 2014 Zyrja e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, në bashkëpunim me Platformën CiviKos organizoi konferencën për promovim të Strategjisë për Bashkëpunim me shoqërinë civile. Në këtë konferencë u promovua Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile. Përveç përfaqësuesve nga shoqëria civile kishte pjesëmarrës edhe nga Qeveria, Komisioni Evropian - Zyra në Kosovë, dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

Punëtori një ditore me Igor Vidacak- drejtues i Zyrës Qeveritare për Bashkëpunim me OJQ në Kroaci

Platforma CiviKos në bashkëpunim dhe me përkrahje të TACSO zyra në Kosovë me datë 29.04.2014 organizoi punëtori një ditore me Zt. Igor Vidacak, i cili është drejtues i Zyrës Qeveritare për Bashkëpunim me OJQ në Kroaci. Në këtë punëtori morën pjesë përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile, ku u diskutua dhe u plotësua dokumenti - Rregullorja e Punës së Këshillit, si dhe u diskutuan modelet e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit. Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqëri Civile si dhe sfidat e implementimit ishin ndër temat që u diskutuan nga të pranishmit me Zt. Vidacak.

Takime informuese rreth mekanizmave përcjellës të Strategjisë Qeveritare

(2013-2017)- Funksionalizimi i këshillit

Menjëherë pas konferencës që kishte për qëllim lansimin dhe promovimin e Strategjisë Qeveritare, në mënyrë që anëtarët e Platformës CiviKos të marrin pronësinë e gjithë procesit, dhe te njoftohen për së afërmi me funksionalizimin e mekanizmave përcjellës të strategjisë siq janë themelimi i këshillit dhe grupeve punuese sipas objektivave strategjike, sekretariati i Platformës CiviKos gjatë muajit Qershor-Korrik 2014 ka organizuar një seri të takimeve konsultative me anëtarë në të gjitha regjionet e Kosovës. Takimet u mbajtën me 25.06.2014 në Mitrovicë, me 26.06.2014 në Ferizaj, me 27.06.2014 në Klinë, me 29.06.2014 në Prizren dhe me 03.07.2014 në Prishtinë. Rekomandimet që kanë dalë nga këto takime me anëtarë kanë ndihmuar sekretariatit e Platformës CiviKos në organizimin e zgjedhjeve të përfaqësuesve të shoqërisë civile në këshill.

Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile

Pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e këshillit dhe një procesi të gjatë të konsultimeve me organizata të shoqërisë civile nëpër të gjitha regjionet e Kosovës që Platforma Civikos ka zhvilluar për termat e referencës së këshillit, ZKM/Zyra për Qeverisje të Mirë me datë 22.07.2014 në ueb faqen e saj shpall ftesën për nominime të përfaqësuesve të shoqërisë civile në këshill. Po ashtu sekretariati i Platformës CiviKos ka publikuar thirrjen, së bashku me dokumentet tjera përcjellëse në ueb faqen e saj, mediet sociale si dhe është ripërsëritur thirrja në mënyrë të vazhdueshme ku janë inkurajuar të gjitha organizatat anëtare dhe jo anëtare të nominojnë përfaqësuesit e tyre.

Pas mbylljes së afatit për nominime Platforma CiviKos ka pranuar gjithsej 32 aplikacione nga ku gjashtë prej tyre kanë qenë nga organizatat jo anëtare në CiviKos, katër nga aplikacionet kanë ardhur nga organizatat që vijnë nga minoritetet që jetojnë në Kosovë. Sa i përket kompozicionit gjinorë dymbëdhjetë kanë qenë gra, dhe nëntëmbëdhjetë meshkuj. Pas verifikimit të aplikacioneve 3 nga kandidatët nuk kanë hyrë në garë pasi nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara.

Verifikimi i nominimeve dhe procesi i votimit

Për të bërë verifikimin e nominimeve Platforma CiviKos ka caktuar një komision të përbërë nga Trëndelinë Dreshaj- Zyrtare nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Petrit Zogaj nga Lëvizja FOL -anëtar i bordit në CiviKos si dhe Mimoza Murati -Koordinatorë e Sekretariatit në Platformën CiviKos.

Pas verifikimit të dokumentacionit 3 kandidat nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara për të qenë pjesë e këshillit, ku një kandidat është vlerësuar se nuk e ka përvojën e kërkuar, tri vite angazhim në Shoqëri Civile dhe 2 përfaqësues janë nominuar nga organizata që veprojnë më pak se tre vite. Në ueb faqen e CiviKos www.civikos.net janë postuar të gjithë aplikacionet e kandidatëve që janë në garë së bashku me cv-t e tyre, si dhe njoftimi është shpërndarë edhe përmes medieve sociale të Platformës CiviKos. Për të qenë sa më transparent në procesin e votimit CiviKos ka huazuar një kuti votimi nga KQZ (Këshilli Qendror i Zgjedhjeve), ku të gjitha votat janë hedhur aty. Votimi ka qenë i hapur nga 09.09.2014 deri më 13.09.2014 ku mundësia e votimit ka qenë përmes e-mailit, postës, dhe personalisht në kuti të votimit në zyrën e CiviKos. Pas përfundimit të afatit gjithsej kanë votuar 42 organizata, 5 nga ata kanë votuar personalisht në zyrë dhe 37 me anë të e-mailit.

Numërimi i votave të përfaqësuesve të OSHC-ve në Këshillin për Zbatim të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile

Sekretariati i Platformës CiviKos, si bartëse e procesit për organizimin e zgjedhjeve për këshillin, dhe në prani të vëzhguesve prezent me datë 18.09.2014 në zyrat e CiviKos, organizoi numërimin e votave për përfaqësuesit e këshillit. Në mënyrë që procesi i numërimit të votave të jetë transparent, CiviKos ka ftuar në cilësinë e vëzhguesve përfaqësues të OSHC-ve, përfaqësues të medieve, asociacione dhe rrjete të ndryshme që veprojnë në Kosovë si dhe përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, si dhe Zyra për Regjistrimin e OJQ-ve Kosovë.

Ftesës për vëzhgues i janë përgjigjur këta përfaqësues: Trëndelinë Dreshaj - ZKM/ZQM, Dren Puka - Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Artan Stavileci- GLPS, Sihana Bejtullahu- Fondacioni Together Kosova.

Pas verifikimit të votuesve u numëruan të gjitha votat ku gjithsej ishin 42 vota, të gjitha të vlefshme. Pas numërimit, pesë kandidatë rezultuan me vota të barabarta ku duke u bazuar në Rregulloren e Punës të Platformës Civikos, anëtarët me numër të barabartë të votave duhet të zgjedhën me short. Pesë kandidat u hodhën në short, ku njëri anëtar nga vëzhguesit tërhoqi emrin e kandidatit i cili në listën përfundimtare renditet në numrin 14.



Lista përfundimtare e anëtarëve të këshillit pas numërimit të votave:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Organizata	Nr. i votave
1	Taulant Hoxha	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile KCSF	22
2	Driton Selmanaj	KDI	21
3	Albert Krasniqi	KIPRED	19
4	Afërdita Syla	CBM	18
5	Besnik Salihu	Agro-Vet Development	15
6	Shpend Emini	Demokracia për Zhvillim D4D	15
7	Bujar Kadriu	Shoqata e te Verbërve të Kosovës	14
8	Mirlinda Kusari - Purrini	Shoqata Afariste e Gruas "SHE-ERA"	14
9	Fidan Kalaja	Lëvizja FOL	13
10	Hilmi Jashari	Civil Rights Program-Kosovo	13
11	Luljeta Demolli	Qendra Kosovare për Studime Gjinore	13
12	Shukrije Gashi	Partners Center for Conflict Management	13
13	Veton Mujaj	Syri i Vizionit	13
14	Naime Sherifi	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve - QMGF	12

Takimi i parë i Këshillit për mbikëqyrje të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017

Pas vendimit për themelimin e Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, me 15.10.2014 u mbajt takimi i parë i këshillit. Takimi u kryesua nga Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit, Fitim Krasniqi dhe Valdete Idrizi, përfaqësuese e Platformës CiviKos, njëherë edhe bashkëkryesuese në këshill. Në këtë takim u miratua Rregullorja e Punës së Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile dhe është marrë vendimi për krijimin e grupeve të punës, në bazë të katër objektivave të identifikuara në Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013- 2017. Ky këshill do të jetë një mekanizëm për zbatimin e Strategjisë Qeveritare dhe zhvillimit të bashkëpunimit të qeverisë së Kosovës me organizatat e shoqërisë civile në Kosovë.



Punëtorja e Këshillit 02-04 dhjetor 2014 në Prevallë

Menjëherë pas konstituimit të këshillit nga 2-4 dhjetor 2014 Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me Platformën CiviKos dhe në përkrahje të TACSO në Kosovë, organizuan punëtorinë tre ditore me anëtarë të këshillit në Hotel Sharri- Prevallë. Qëllimi i punëtorisë ishte hartimi i planit të punës së këshillit për vitin 2015.

Kjo punëtori shërbeu për përcaktimin e prioriteteve për vitin 2015 dhe poashtu përcaktimin e hapave që duhet të ndërmerren për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara sipas planit të punës.



Takimi i dytë i Këshillit për mbikëqyrje të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017

Takimi i dytë i Këshillit u mbajt me 19.12.2014. Në këtë takim u konfirmua përkrahja e vazhdueshme edhe nga qeveriar e re e saporformuar. Në këtë takim u diskutua për uebfaqjen e re të ZKM/ZQM me fokus të veçantë në Strategji, e cila sapo është lansuar. Poashtu u aprovua edhe Plani i Punës për vitin 2015 i cili u hartua në punëtorinë tre ditore në Prevallë. Valdete Idrizi lajmëroi se këshilli do të monitorohet edhe nga grupet punuese që do të formohen nga Platforma CiviKos. U diskutua edhe për përzgjedhjen e kordinatorëve të grupeve punuese të këshillit, ku sipas rregullores së këshillit vetë grupet punuese e përcaktojnë kordinatorin.

CiviKos u zotua për ofrimin e ndihmës teknike në organizimin e punëtorive me rrjetin CNVOS nga Sllovenia gjatë muajit shkurt 2015 si dhe me Zyren për OJQ nga Kroacia gjatë pjesës së parë të vitit 2015. Këto punëtori do të shërbejnë për shkëmbin e përvojave dhe njohurive me vendet e rajonit.

Konsultime me organizatat anëtare - Nëntor 2014 - Themelimi i grupeve punuese sipas objektivave strategjike.

Platforma CiviKos me përkrahje të Friedrich Erbert Stiftung (FES) gjatë muajit tetor-nëntor 2014 ka organizuar një seri të konsultimeve me anëtarë në gjashtë regjione të Kosovës. Qëllimi i këtyre konsultimeve ishte njoftimi për së afërmi i anëtarëve me zhvillimet e fundit në Platformën CiviKos me theks të veçantë në krijimin e grupeve punuese të Platformës CiviKos sipas objektivave strategjike të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017. Takimet u mbajtën me 11.10.2014 në Pejë, 12.11.2014 në Gjilan, 13.11.2014 në Prizren, 14.11.2014 në Mitrovicë, 24.11.2014 në Mitrovicën e veriut dhe 27.11.2014 në Prishtinë.



Konsultimet publike me anëtarë

Sekretariati i Platformës CiviKos në mënyrë të vazhdueshme ka përcjellë të gjitha draft-ligjet që kanë ardhur për konsultim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në të gjitha draft-ligjet të cilat nuk i kanë respektuar afatin e konsultimeve publike, gjuhën zyrtare serbe, si dhe nuk i kanë pasë tabelat për komente apo dokumentet përcjellëse, CiviKos ka kontaktuar zyrtarët përgjegjës ku është intervenuar duke kërkuar që të gjitha draft-ligjet që vijnë për konsultim me shoqërinë civile të jenë në të dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe të respektohet afati kohor në pajtim me nenin 32 të Rregullores së Punës së Qeverisë 09/2011.

Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës për shënimin e “Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë”

Platforma CiviKos së bashku me Sekretariatit e Kuvendit të Kosovës ka marrë pjesë në përgatitjet për organizimin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë me 15 Shtator 2014, ku Platforma CiviKos ndihmoi në koordinimin e aktiviteteve në mes të Kuvendit të Kosovës dhe organizatave anëtare. Panairi i OJQ-ve u mbajt me 15 Shtator, ku edhe Sekretariati i Platformës CiviKos morri pjesë duke prezantuar materiale promovuese të ndryshme.



Takimet e bordit të Platformës CiviKos gjatë vitit 2014

Përveq takimeve jo formale që anëtarët e bordit kanë zhvilluar mes vete dhe me sekretariatit e CiviKos, dhe poashtu formimin e grupeve më të vogla punuese për çështje të ndryshme të ndërlidhura me Platformën CiviKos, gjatë vitit 2014 janë mbajtur gjithsej 4 takime të rregullta të bordit.

11.02.2014- Takimi i tetë i bordit të Platformës CiviKos.

15.05.2014 - Takimi i nëntë (takimi i parë i bordit të ri) të Platformës CiviKos, i zgjedhur në kuvendin e fundit të anëtarëve.

22.10.2014 – Takim i dhjetë i bordit të Platformës CiviKos.

17.12.2014 – Takimi i njëmbëdhjetë i bordit të Platformës CiviKos.

Për të komunikuar drejtpërdrejt me Bordin e Platformës CiviKos, ju lutem që komunikimin ta drejtoni në këtë email: bordi@civikos.net



Përkrahja e Komisionit Evropian përmes projektit “Duke punuar së bashku. Drejt një marrëdhënie pune produktive në mes të Shoqërisë Civile dhe Autoriteteve në Kosovë”

Faza e parë e projektit “Duke punuar së bashku” e mbështetur nga Komisioni Evropian mbaroi në fund të Shtatorit 2014. Të arriturat kryesore të këtij projekti janë: përkrahja e procesit për krijimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013 - 2017, fuqizimi i Platformës CiviKos, përkrahja dhënë nismave tjera të bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë.

CiviKos vazhdon të mbështetet nga Komisioni Evropian edhe për dy vitet e ardhshme duke zbatuar pjesën e dytë të projektit “Duke punuar së bashku”. Në kuadër të këtij projekti u organizuan edhe takimet e rregullta të komisionit udhëheqës të projektit, që u mbajtën me 20.05.2014 dhe 30.09.2014.

Komunikimi me anëtarë

Përveç takimeve formale dhe joformale që CiviKos i organizon me anëtarë në të gjitha regjionet e Kosovës, sekretariati i Platformës CiviKos në mënyrë të vazhdueshme ka përcjellë të gjitha draft-ligjet dhe draft udhëzimet administrative që kanë ardhur për konsultim nga qeveria e Republikës së Kosovës përmes emailit, ueb faqes dhe medieve sociale. Për të lehtësuar procesin e konsultimeve publike në ueb-faqën e CiviKos është vendosur edhe udhëzuesi për konsultime publike dokument i cili është punuar nga KCSF në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit dhe është dokument zyrtar i qeverisë së Republikës së Kosovës. Përveç thirrjeve për kontribute në draft-projektligje dhe Udhëzime Administrative që vijnë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sekretariati i Platformës CiviKos në mënyrë të vazhdueshme dhe në pajtim me Rregulloren e Punës të CiviKos ka përcjellë informata për anëtarë si thirrje për grante, mundësi pjesëmarrje në evente të ndryshme, raporte relevante për shoqërinë civile si dhe informata të ndryshme në interes të punës së përditshme të organizatave të shoqërisë civile.

Sekretariati i Platformës CiviKos në mënyrë të vazhdueshme monitoron procesin e konsultimeve publike, dhe reagon në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha parregullsitë që shfaqen gjatë këtij procesi si që janë mos dërgimi i draft-projektligjeve në dy gjuhët zyrtare, ose mos respektimi i afatit prej 15 ditësh.

Në mënyrë që shërbimi informues ndaj anëtarëve të jetë sa më efikas dhe afër nevojave të organizatave anëtare, Sekretariati i Platformës CiviKos ka organizuar një hulumtim me shumicën e OSHC-ve anëtare nga

të gjitha regionet e Kosovës, ku rezultatet e këtij hulumtimi do të dalin në janar 2015 dhe do të shërbejnë si bazë për vazhdimin/përmirësimin e këtij shërbimi ndaj anëtarëve.

Në periudhën Janar- Dhjetorë 2014 nga sekretariati i Platformës CiviKos janë përcjellë gjithsej 48 draft projekt ligje dhe udhëzime administrative për konsultim publikë dhe rreth 53 njoftime të ndryshme si mundësi për grante, pjesëmarrje në konferenca të ndryshme etj.

Strategjia e Komunikimit dhe Buletini i CiviKos

Në mënyrë që komunikimi me anëtarë të jetë sa më efektiv dhe i strukturuar CiviKos ka përpiluar Strategjinë për Marrëdhënie me Publikun të Platformës CiviKos për vitin 2015-2017.

Në vazhdimësinë e informimit të rregullt të organizatave anëtare, me 15 gusht 2014 u lëshua numri i parë i buletinit elektronik të CiviKos-it, ndërsa me 18.11.2014 u dërguar buletini nr 2. CiviKos do të vazhdojë të shpërndaj tek anëtarët e saj buletinet e rregullta të cilat do të përcjellen çdo tre muaj.

Përveç komunikimit me email Sekretariati i CiviKos në mënyrë të vazhdueshme ka postuar informata në ueb faqen e CiviKos, si dhe përmes rrjeteve sociale të CiviKos si facebook, twitter, linkedin etj.

CiviKos në Media

Prezenca e CiviKos në media gjatë vitit 2014 është rritur. CiviKos ka pasur paraqitje të shumëta në media televizive, elektronike dhe ato të shkruara. Fokusi më i veçantë ishte përzgjedhja e përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshillin për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare.

Disa nga paraqitjet në media:

- 14.07.2014 - Drejtoresha Ekzekutive e Platformës CiviKos Valdete Idrizi ishte e ftuar në emisionin e mëngjesit në KTV (Koha Vizion) për të biseduar rreth “Rolit të gruas në ndërtimin e paqes”. Gjithashtu në këtë paraqitje u përmend edhe puna e CiviKos.
- 21.07.2014 - Udhëheqësja e Platformës CiviKos Valdete Idrizi ishte mysafire në emisionin Vizion Show, ku temë debati ishte Varfëria dhe Pabarazia Sociale në Kosovë.
- 24.07.2014 - Udhëheqësja e Platformës CiviKos Valdete Idrizi ishte e ftuar në emisionin e mëngjesit në RTK së bashku me drejtorin e Zyrës për Qeverisje të Mirë Habit Hajredini, ku biseduan rreth formimit të Këshillit për Mbikëqyrje të Strategjisë Qeveritare 2013-2017, dhe procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Shoqërisë Civile.
- 25.07.2014 - Udhëheqësja e Platformës CiviKos Valdete Idrizi u ftua në emisionin “Bon Bon” të RTV 21 ku diskutoi rreth formimit të Këshillit për mbikëqyrje të Strategjisë Qeveritare 2013-2017, procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të OSHC-ve në këtë këshill dhe në përgjithësi për aktivitetet e Platformës CiviKos.
- 23.07.2014 në www.telegrafi.com publikohet informata në lidhje me përzgjedhjen e përfaqësuesve të Shoqërisë Civile në Këshill.
- 23.07.2014 Njoftimi për thirrjen për nominime të përfaqësuesve të Shoqërisë Civile në Këshill nga www.koha.net
- 11.09.2013 Zyrtarja për Komunikim dhe Raportim Ardiana Osmani ishte e ftuar në emisionin “Bon Bon” në Rtv21 ku bisedoi rreth procesit të votimit për anëtarët e këshillit.

